



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
OPERATORI I SHËRBIMEVE TE KUJDESIT SHËNDETËSOR
SPITALI RAJONAL SHKODËR

Nr. _____ prot.

Shkodër, më _____.____.2024

MIRATOHET
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SENAD HALLUNAJ

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “F.V Sistemit të Histereskopisë”,

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodet CPV: - 33100000-1 (Pajisje Mjekesore)

VLERA E FONDIT LIMIT: 6,429,432.00 (gjashtëmilion e katërqind e njetzet e nentemije e katërqind e tridhjetë e dy)lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Spitalit Rajonal Shkoder ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 .;
- b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit

Operatori ekonomik duhet të paraqesë të gjitha shtojcat sipas DST-ve të tenderit që janë Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik(Formularin e Ofertës sipas Shtojcës 1,Lista e cmimeve te artikujve sipas shtojces 2).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të kontratës.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa ”c”, 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.

Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së të vlerës së fondit limit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore (libri i shitjes), ku shënohen datat, shumat dhe mallrave të furnizuara.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, dhe neni 55 pika 4 b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën e cila nuk tejkalon 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimin të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion dhe keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancojë se furnizimi të mallit objekt prokurimi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për pajisjen e kërkuar në formë të tabelave, ku të plotësohet: Specifikimet teknike të ofruara, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut të artikullit/produktit, Numri i faqes ku ndodhet produkti, Numri I referencës së artikullit (**kodi**) nxjerrë nga katalogu i prodhuesit, si dhe **certifikimet perkatese per produktin**.

Argumentimi Ky kriter vendoset bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën për përmbushjen e afatit të garancisë dhe aksesoret shoqerues, sipas përcaktimeve në specifikimet teknike të DST, ku të saktësojë se periudha e garancisë të jetë jo më pak se 2 vjet përshirë blerjen, dhe zëvendësimin e pjesëve të difektuara me pjesë këmbimi të reja të cilat të jenë *originale ose ekuivalente* dhe në përputhje me ato të përdorura fillimisht.

Argumentimi: Bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 2 të nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vetëdeklaratë, që pajisja e ofruar është e re, të një prodhimi original.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë me të dhënat teknike për pajisjen e ofruar bashkë me aksesoret shoqerues ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun perkates produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në ofertën teknike. (Katalogu duhet të ngarkohet në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DST. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe në pjesët që kanë lidhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST).

Argumentimi Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose;

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë pajisjet mjekësore objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në

momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave; dhe origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikat 2 dhe 4 të nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku është e cituar: Pika 5. *”Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/entikontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkak që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.* Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet nga ana e njësisë së prokurimit si e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”, I ndryshur .Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në kohën e zhvillimit të tenderit deri në ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe Në Ligjin Nr. 89/2014 “Për Pajisjet Mjekësore” neni 21 i tij

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar ISO 9001 për import/ eksport/ tregtim të pajisjeve mjekësore /ose/ ekuivalent. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse, të vlefshme.

Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues në rastet kur nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet të paraqesë autodeklarate që furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi është konform standarteve të cilësive ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose EN ISO 13485 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”ose SSH EN ISO 13485 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, të vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Vetëdeklarimi do të verifikohet në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, dhe në rastin e shpalljes fitues, OE do të dorëzojë Certifikatën në fjalë.

Argumentimi : Në bazë të nenit 79/1 , të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe neneve 40 si dhe 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se mallrat objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u

kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;b) efikasitetit të energjisë;c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autodeklarate për pajisjet mjekesore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat MDD 93/42/EEC (ose MDR) ose IVD 98/79 EC (të përditësuar), ose EU 2016/425 (të përditësuar) ose FDA ose (EU) 2017/745, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, bashkelidhur me kopjet e certifikatave perkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.

Argumentimi për kriterin 2.3.6: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3.4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se Certifikatat perkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1(nje) inxhinierë të trajnuar për instalim dhe servis pajisjesh mjekesore me profil inxhinier biomjekësor/elektronik/elektrik/mekatronik/IT. Për këtë OE duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese për inxhinierin e mësipërm:

- Diploma
- Çertifikatat/dëshmitë e trajnimit për pajisjen objekt prokurimi
- Kontratë pune/ shërbimi e vlefshme.
- Listepagesat e deklaruara në organet tatimore(formulet E-sig 025) në tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit për inxhinierat bazuar në vkm nr 514 date 20.09.2017 “Për miratimin e listes kombëtare të profesioneve”.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi:Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 5/b dhe 5/c , neni 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën se Inxhinieri do të jetë personi përgjegjës për instalimin e aparaturave mjekesore dhe për trajnimin e stafit spitalor (mjeke,infermier,inxhinier) për përdorimin e sakte të aparaturave mjekesore.

Argumentimi:Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 5/b dhe 5/c , neni 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

2.3.13 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vetëdeklarim që pajisjet mjekesore që do të përdoren gjatë zbatimit të kontratës dhe që i nënshtrohen kërkesave të ligjit nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”, i ndryshuar, duhet të jenë të regjistruara pranë AKBPM, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

F.V Sistemit të Histeroskopisë		Cope	1
	Pjesët Perberese	Specifikimet Teknike	
a.	Monitor	Monitor me madhësi 27” Full HD I grades mjekesore Resolucion të pakten 1920x1080. Daljet video(Video Outputs): Te pakten 1xDVI,1x3G-SDI,1xComposite	
b.	Karrel Mbajtes	Te kete te pakten tre ndarje per vendosjen e uniteve te histeroskopise. Te kete support fiksime per monitorin. Te kete kabull ushqimi qendror me celes On/OFF. Karreli te vije I paisur me kater rrota antistatike nga te cilat te pakten dy te jene me frena	
c.	Videoprocesor Imazhi	Videoprocesor per perpunimin e sinjalit te percjelle nga kamera e histeroskopise(imazhi Full HD). I pajisur me vend USB dhe Flash USB memory per eksport imazhesh dhe videosh Te kryeje balancimin automatik te ngjyrave (white balance) Funksion per ndalimin dhe zmadhimin e imazhit Funksion per rrotullimin dhe pasqyrimin e imazhit Me dalje video dixhitale DVI ose HDMI per lidhjen e ekrave te jashtem Mundesi lidhje me pajisje periferike si tastiere, maus, printer, etj. Ekрани Full HD	
d.	Kamera e Histeroskopise	Me dy butona te programueshem. E pershtashme per te operuar me videoprocesorin e mesiperme Me rezolucion Full HD dhe e fokusueshme Me konektor fiksime (c-mount) per histeroskopise	
e.	Burim Drite	<ul style="list-style-type: none"> • Burim Drite I teknologjise LED Tension hyrje 220V, 50 Hz <ul style="list-style-type: none"> • Kabulli I drites me gjatesi 3 m dhe trashesi 3.5mm 	

		<ul style="list-style-type: none"> • koka te burimi I drites • Koka te endoskopi anesor <p>Kompatibel me kameran e histeroskopise. Me rregullim te intensitetit te ndricimit Temperatura e ndricimit te pakten 6000K \pm 10%</p>
f.	Pompe Thithje dhe Irrigimi(Suction Irrigation Pump)	<ul style="list-style-type: none"> • Pompe suction-irrigation per perdorim ne histeroskopi <p>Tensioni I hyrjes 220 V 50 Hz Flow Rate(fluksi I rrjedhjes) per perdorim ne histeroskopi \geq0.1 Liter/min Te vije e furnizuar me sete tubash Set tubash irrigimi me histeroskopi, i sterilizueshem</p> <ul style="list-style-type: none"> • Set tubash aspirimi, I sterilizueshem <p>Ushqimi: 220 V 50 Hz</p>
g.	Teleskope	<ul style="list-style-type: none"> • Teleskop oblik 30°,me diameter 2mm,gjatesi 26cm,I sterilizueshem me vend fiksimi te kokes te cameras dhe te burimi I drites
		<ul style="list-style-type: none"> • Teleskop oblik 30°,me diameter 2.9 mm,gjatesi 30.2 cm,I sterilizueshem me vend fiksimi te kokes se cameras dhe te burimi I drites
		<ul style="list-style-type: none"> • Teleskop oblik 12°,me diameter 2.9 mm,gjatesi 30.2 cm,I sterilizueshem me vend fiksimi te kokes se cameras dhe te burimi I drites
		<ul style="list-style-type: none"> • Inner sheath me kanal pune 5 Fr dhe lidhje Inflow I pershtatshem me teleskopet e lart permendur
		<ul style="list-style-type: none"> • Outer sheath I pershtatshem ne permasa me inner sheath e lartpermendur dhe lidhje outflow
i.	Instrumentat	<ul style="list-style-type: none"> • Gershere jo te mprehta, jo te ngurta, me diameter jo me te madh se 5 Fr dhe gjatesi \geq 35 cm.
		<ul style="list-style-type: none"> • Pince per kapje me diameter jo me te madh se 5 Fr dhe gjatesi \geq 35 cm
		<ul style="list-style-type: none"> • Pince per kapje dhe biopsi, me diameter jo me te madh se 5 Fr dhe gjatesi rreth \geq 35 cm
j.	Njesi Elektrogjikale	<ul style="list-style-type: none"> • Njesi elektrokirurgjikale e perdorshme per histeroskopi me tension hyrje 220 Volt 50 Hz dhe ne dalje te kemi tension unipolar dhe bipolar. Te jete e paisur me pedal Cut/Coagulation. <p>Fuqia maksimale ne modalitetin monopolar dhe bipolar deri ne 400W . Te jete e paisur me pllake tokezimi te riperdorshme dhe te gjitha kabllot e nevojshme</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kabllot qe lidhen me rezektoskopin(bipolar electrode cable).
k.	Rezektoskopi	<ul style="list-style-type: none"> • Element punues bipolar aktiv 22Fr
		<ul style="list-style-type: none"> • Outer Sheath per rezektoskopin bipolar me lidhje inflow dhe outflow 22 Fr
		<ul style="list-style-type: none"> • Inner Sheath I rezektoskopit bipolar 30° ,I rrotullueshem me izolim qeramike.
		<ul style="list-style-type: none"> • I paisur me obturator per Inner Sheath te rezektoskopit.
l.	Instrumentat Kirurgjikal	<ul style="list-style-type: none"> • Elektrode, bipolare per prerje te drejte te polipeve dhe miomave (1 set – 6 cope)
		<ul style="list-style-type: none"> • Elektrode, bipolare per prerje me kend te polipeve dhe miomave (1 set – 6 cope)
		<ul style="list-style-type: none"> • Elektrode bipolare me maje prerese per septumin (1 set – 6 cope)
		<ul style="list-style-type: none"> • Electrode bipolare me fund sferik, per koagulim/ablacion (1 set – 6 cope)

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit

40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Dokumentat e tenderit janë hartuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Referuar pikës 5 të nenit 82 të Ligjit 162 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik” operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike si dhe dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna, jo me vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar.

NJËSIA E PROKURIMIT

NJESIA E PROKURIMIT

Nermin Agovi

Brixhilda Lazri

Arjola Basha